



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 315, datë 14.09.2020

PËR
PEZULLIMIN NGA DETYRA TË MAGJISTRATES {...}, ME DETYRË GJYQTARE
NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS, CAKTUAR NË SKEMËN E
DELEGIMIT NË GJYKATËN E APELIT KORÇË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 140 pika 3, germa a), dhe nenin 147/a, pika 1, germa b) të Kushtetutës, në nenin 61, pika 2 germa b), në nenin 97, pika 1, germa a) të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 151, pika 1, germa a) dhe 155 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi informacionin e njoftuar me shkresën rr.6108 prot., datë 10.09.2020 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe informacionin e njoftuar me shkresën nr.912 prot., datë 14.09.2020 e Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbi propozimin e Komisionit Disiplinor,

V E N D O S I :

1. Pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, caktuar në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet magjistrates {...}, sipas kërkesave të nenit 98, pika 1 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publike në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR